



**Shqyrtimi i Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE5)  
Komente ndaj Raportit Konsultativ të ZRrE**

4 mars 2011

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-CLRR-032</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faje 2 nga 11</i>

## **Përmbajtja:**

1. Hyrje
2. Zbatimi i kornizës rregullative në shqyrtimin e tarifave të transmisionit;
3. Komentimi i principeve të zbatuara që kanë sjell rezultat jo të balancuar;
4. Komentimi i pjesëve të veçanta të Raportit Konsultativ-KOSTT në Shqyrtimin e Pestë të Tarifave të Energjisë Elektrike SHTE 5 (2011-2012)
  - 4.1 Humbjet e energjisë në transmision
  - 4.2 Kapitalizimi i Mirëmbajtjes
  - 4.3 Shpenzimet e Personelit
  - 4.4 Shërbimet ndihmëse
  - 4.5 Shpenzimet tjera
  - 4.6 Problematika e financimit të projekteve kapitale 2011 nga BK
5. Kërkesat e KOSTT për t'u marrë parasysh në Vendimin Final

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-CLRR-032</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajë 3 nga 11</i>

## 1. Hyrje

Me 22.02.2011 KOSTT me anë të Raportit Konsultativ ka pranuar propozimet e Zyrës së Rregullatorit për Energji për Shpenzimet Operative dhe Kapitale për vitin 2011.

KOSTT me këtë dokument ka dhënë komentet ndaj Raportit Konsultativ duke u bazuar në arsyetimet profesionale dhe ligjore respektivisht në Metodologjinë e Tarifave, nenet e së cilës janë cituar në këtë dokument (4.2.2; 4.3; 6.2; 6.5; 4.8; 4.4; 4.9) të cilat mbështesin kërkesat e KOSTT.

Për vitin 2011 KOSTT paraqet kërkesën për Të Hyrat Totale prej 15,7 milionë euro e cila është 13% më e vogël se Të Hyrat e Lejuara të vitit 2010.

Në kuadër të kësaj kërkesë, gjithashtu ka zvogëlim të dukshëm ndaj Shpenzimeve Operative të Lejuara për vitin 2010, respektivisht 20%.

## 2. Zbatimi i kornizës rregullative në shqyrtimin e tarifave të transmisionit

Për sa i përket kornizës rregullative për përcaktimin e lartësisë së tarifave për vitin 2011, hera e parë është që ato janë zbatuar ndryshe nga vitet e mëparshme dhe me ndikime signifikante në të hyrat e KOSTT. Ka një jokonsistencë parimore ku aplikacioni për tarifa trajtohet si aplikacion për shqyrtim periodik të çmimit dhe është zbatuar i ashtuquajtur i “tavanim” i të hyrave dhe nga zbritjet e kostove të KOSTT dhe të KEK krijohet Llogaria Balancuese e Tarifave. Kur është fjala për KEK është një paqartësi në Raportin Konsultativ të KEK se si do të implementohet. Një fakt është i sigurtë, se realizimet si në KOSTT ashtu edhe në KEK, kanë me qenë më të mëdha nga ato të planifikuara, meqenëse bilanci e energjisë për vitin 2011 janë më të vogla se ato që realisht kanë për të ndodhur. Për më tepër, për herë të parë bilanci i energjisë i KEK që do të hyjë në transmision është ende më i vogël se ai i KOSTT!

Për sa i përket tavanimit të të hyrave nga procesi i Shqyrtimit të Çmimit që një herë zbatohet nuk ka pse të zbatohet edhe në Shqyrtimin e Tarifës nëse nuk janë krijuar kushtet e zbatimit të “Rihapjes” si kategori e veçantë e rregullimit të çmimit i paraparë në Rregullin mbi Çmimin dhe Metodologjinë Tarifore (në tekstin e mëtejme Metodologjia).

Në vazhdim po ua paraqesim dispozitat e Metodologjisë që sanksionojnë konstatimet e më larta si:

### *OSTT kapitulli*

#### **4.2.2 Rregullimi i bazuar në stimulim**

*Sipas kësaj, ZRrE-ja do të përcaktojë të ardhurat e lejuara për OST-në, për një periudhë kontrolli të çmimeve, që zgjatë një sërë vitesh (si në qasjet e mirënjohura të çmimit tavan dhe të ardhurave vjetore tavan), bazuar në parashikimin e niveleve efikase të kostove gjatë kësaj periudhe. Këta kufij do të përcaktohen në kushte të vërteta. Të ardhurat vjetore të lejuara, do të indeksohen brenda kësaj periudhe me anë të disa masave të ndryshimeve në kostot e hyra të OST-së. Kjo jep formulën e përgjithshme në vijim, për të përcaktuar të ardhurat vjetore të lejuara për OST-në gjatë çdo viti të periudhës së kontrollit të çmimeve:*

$$REV_t = REV_{t-1} * (1 + CI_t - X)$$

$REV_t$  - të ardhurat vjetore të lejuara (të shprehura si të ardhura vjetore maksimale, të ardhurat vjetore mesatare të njësisë, ose koshi i tarifave)

$CI_t$  - treguesi i ndryshimit në kosto të të hyrave (%)

$X$  - ndryshimi i vërtetë në të ardhurat vjetore të lejuara (%) – përcaktuar nga ZRrE

Në fund të periudhës së kontrollit të çmimeve, ZRrE-ja do të shqyrtojë të gjitha kostot reale kundrejt niveleve të lejuara dhe do të rivendosë pikën filluese të kontrollit të çmimeve, në mënyrë që të marrë parasysh dallimin midis tyre. Pas kësaj, do të fillojë një periudhë e re e kontrollit të çmimeve.

#### 4.3 Qasja e ndërtimit të blloqeve

Vlera aktuale e të ardhurave të lejuara mbi periudhën e kontrollit të çmimeve, do të jetë e njëjtë me vlerën aktuale të kostove të lejuara, të përlllogaritura si më sipër. Sidoqoftë, në vite të veçantë, vlera e të ardhurave të lejuara, mund të jetë më e madhe ose më e vogël se vlera e kostove të lejuara, në mënyrë që të lejojë një profil më të qëndrueshëm të çmimeve për konsumatorët. Ky proces është përshkruar me më shumë detaje në seksionet vijuese.

### OSSH kapitulli

#### 6.2 Parimet e Përgjithshme

Shpenzimet dhe të ardhurat e lejuara për OSSH-në përlllogariten në mënyrë të ngjashme me ato të OST-së (shiko seksionin 4). Prandaj këto parime dhe pjesa tjetër e këtij seksioni përshkruajnë aspektet e përlllogaritjes që dallojnë nga ato që aplikohen në OST.

#### 6.5 Kontrolli i çmimit

Numri i konsumatorëve dhe sasi të shpërndara ndikojnë në kostot e OSSH-së. ZRrE-ja pret që të lidhë komponentin e çmimit tavan të kontrollit me vetë sasi të.

#### 3.6 Kostot e shitjes me pakicë

Equation 3-2 Public Supplier Revenues

$$SUPL_t = \{PPUR_t * (1 + MARG_t)\} + (RETL_t * NCUS_t) - SUBV_t + KPS_t$$

$SUPL_t$  Maximum allowed revenue for the public supplier in year  $t$  for the supply of electricity to non-eligible customers .(this excludes the supply of energy for network losses under the contracts with KEK Distribution and KEK

Public Supply)-është shfrytëzuar teksti anglisht me që në tekstin shqip të Metodologjisë së Tarifave mungon ky definicion

#### 4.2.2 Rregullimi i bazuar në stimulim

ZRrE-ja njih se pasiguritë e trashëguara në ambientin aktual Kosovar, vendosin rreziqe të mëdha mbi OST-në dhe mbi konsumatorët, përfitimet e të cilave mund të jenë jashtëzakonisht të lartë ose të ulët për shkak të rrethanave jashtë kontrollit

*të OST-së dhe nuk mund të parashikohen apo të maten si duhet në kohën e vendosjes së kontrollit të çmimit. Për të mbrojtur kundër kësaj, ZRrE-ja gjatë periudhës së kontrollit të parë të çmimit, do të aplikojë “rihapjen”, sipas së cilës, në rast të rrjedhëve të jashtëzakonshme, do të ndodhë një shqyrtim i përkohshëm i kontrollit të çmimit.*

### **3. Komentimi i dispozitave rregullative të zbatuara, që kanë sjellë rezultat jo të balancuar**

Është e vërtetë se ZRrE duke gjykuar nga kërkesat e ristrukturimit të sektorit që i referohen dy aktiviteteve të mëdha të qeverisë si futjen e investitorëve privat në Gjenerim dhe në Shpërndarje&Furnizim, nuk ka hapur procesin e ri të shqyrtimit të çmimit në vitin 2009 por ka vazhduar me atë të vjetrin, gjendje kjo që ka pamundësuar të mendohet për një planifikim që do të mund të konsiderohej strategjik.

Gjithashtu për sa i përket gjendjes në Kosovë në raport me marrëdhëniet ende të pa zgjidhura politike në tërësinë e vet dhe si pasojë, mos arkëtimi i të hyrave nga kooperimi ndërmjet transmiseve të Evropës dhe mosfunksionimi i tregut financiar për investime kapitale, paraqiten rreziqe që shpeshherë operatorët kur aplikojnë për tarifa mundohen t'i tejkalojnë. Prandaj, komentimi i mëtejme i disa korrigjimeve të kostove në Raportin Konsultativ, gjithnjë duhet shikuar edhe nga ky këndvështrim.

### **4. Komentimi i pjesëve të veçanta të Raportit Konsultativ-KOSTT në Shqyrtimin e Pestë të Tarifave të Energjisë Elektrike SHTE 5 (2011-2012)**

#### **4.1 Humbjet e energjisë në transmision**

Në kapitullin 2 të Raportit Konsultativ-KOSTT, është bërë konstatimi se KOSTT ka keqkuptuar mekanizmin nxitës të ZRrE lidhur me humbjet. Mekanizmi nxitës i referohet nxitjes së zvogëlimit të kostove. Në asnjë vend në Metodologji nuk është shkruar se humbjet duhet përjashtuar nga mekanizmi. Për të u diskutuar mund të jetë se cila vlerë do të konsiderohet për nxitje nga diferencat e arritura ndërmjet humbjeve të lejuara dhe atyre të realizuara. Propozimi i ZRrE për lartësinë e humbjeve prej 130.5 GWh ka bazën e një automatizmi të zbatimit të përqindjes së realizuar 2.3% në 2010, përkundër analizave që KOSTT ia ka bashkangjitur kërkesës së ZRrE.

Lidhur me konstatimin në Raportin Konsultativ për KEK është përdorur krahasimi me humbjet e KOSTT kur janë përshtatur humbjet e KEK. Kjo nuk mund të merret si bazë meqenëse kemi dy procese, që duke i referuar të dhënave të prezantuara, njëri ka tendencën e rritjes ndërsa tjetri zvogëlimit i cili nuk nxitet. Mund të konsiderojmë se deri në 30% të diferencës së kursyer të humbjeve të energjisë mund të paraqesin si nxitje e që mund të llogaritet me formulën : (Humbje të lejuara 2010 – Humbje të realizuara 2010) x 0.3, dmth. (166GWh-131GWh) x0.3=10.5 GWh dhe

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-CLRR-032</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 6 nga 11</i>

vlera e propozuar prej 130.5 GWh do të ishte 141GWh. Vlera monetare e humbjeve do të rritej për 313.5 €.

Në vazhdim paraqitet baza rregullative për kërkesën e KOSTT lidhur me humbjet:

#### **4.8 Humbjet**

*Kostove të lejuara të përcaktuara në këtë mënyrë, ju shtohet shuma e lejuar e humbjeve të arsyeshme të transmisionit. Kjo shumë e lejuar shfrytëzohet nga OST-ja që të kompensojë furnizuesit për kostot e humbjeve të përcaktuara nën Rregullat e Tregut, siç diskutohet në Seksionin 3.5 dhe siç është ilustruar në Figurën 2. Vlera e lejuar, së paku fillimisht, do të kalkulohet si çmim stimulues i tregut në çdo orë, shumëzuar me sasinë e energjisë se parashikuar që hyn në transmetim në atë orë, dhe shumëzuar me nivelin e humbjes së lejuar që aplikohet në atë orë. Në fund të çdo viti do të bëhet një krahasim në mes të të ardhurave të rigjeneruara përmes kësaj qasjeje dhe atyre që do të ishin rigjeneruar nëse do të ishte bërë kalkulimi duke përdorur çmimet reale të tregut dhe sasinë e energjisë, përderisa vazhdohet të aplikohen nivelet e lejuara të humbjeve më parë se nivelet reale të humbjeve, në çdo orë. Ndryshimi do të aplikohet si një faktorë korigjues për të ardhurat e lejuara të OST në vitin vijues. Ky proces do të administrohet përmes mekanizmit të marrëveshjes të përshkruar në Rregullat e Tregut (përfshirë çdo rregull kalimtar që do të aplikohet).*

*Humbjet e lejuara do të përfshijnë humbjet që kanë të bëjnë me transitin e energjisë përgjatë rrjetit kosovar. Kostot e shoqëruara me këto humbje transite, do të mbulohen gjatë vitit vijues prej pagesave për shfrytëzimin e rrjetit të OST-së për transitin ndërkombëtar të energjisë elektrike sipas Mekanizmit Kompensues Ndër-OST (MKN). Pagesat neto të marra sipas MKN-së do të përçohen tek konsumatorët, të cilët do të kompensohen për humbjet në transit që janë paguar gjatë vitit të mëparshëm*

#### **4.2.2 Rregullimi i bazuar në stimulim**

*Kjo qasje siguron stimuj të fortë ndaj OST-së për të ulur kostot në mënyrë shumë të shpejtë, në nivele të efikasitetit të “vërtetë”. Në rast se mund të ulë kostot poshtë nivelit të parashikuar prej ZRrE-së, në vendosjen e të ardhurave vjetore të lejuara, atëherë OST-ja mund të mbajë përfitimet në formë të fitimeve të rritura, deri në shqyrtimin tjetër të çmimeve, kur ZRrE-ja do të rregullojë kostot e lejuara për të pasqyruar nivelin real të arritur. Po kështu, në rast se kostot e kalojnë nivelin e parashikuar, atëherë OST-ja do të shohë që fitimet e saj janë ulur. Në të njëjtën mënyrë, shqyrtimet vjetore të kostove të lejuara nuk lejojnë që OST-ja të mbajë përfitimet prej efikasitetit të rritur dhe në këtë mënyrë, heqin stimujt e saj për të arritur këtë.*

*Shfrytëzimi i periudhës së kontrollit shumëvjeçar të çmimeve, ofron përfitime për OST-në dhe konsumatorët, duke krijuar çmime më të qëndrueshme dhe të parashikueshëm. Në një ambient si Kosova, kjo ka rëndësi të veçantë sepse është me rëndësi jetike që të inkurajohen investimet e reja në industrinë e energjisë elektrike.*

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-CLRR-032</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajë 7 nga 11</i>

## 4.2 Kapitalizimi i Mirëmbajtjes

Sipas Metodologjisë Tarifore të gjitha asetet para vitit 2006 janë vlerësuar zero. Mirëpo duke qenë në dijeni se këto asete ekzistojnë fizikisht dhe funksionojnë, për të mirëmbajtur dhe ripërtëritur këto asete, Metodologjia Tarifore ka vendosur “pagesën për ripërtëritje” në kuadër të shpenzimeve të mirëmbajtjes.

KOSTT është i obliguar nga ligji mbi Tatimin e Korporatave neni 18, që vlerën e mirëmbajtjes e cila kalon vlerën prej 1.000 € si dhe vlerën e mirëmbajtjes e cila e zgjatë jetën e përdorimit të asetit për një vit, ta kapitalizojë. Gjithashtu në Udhëzimet për Kontabilitetin Rregullativ seksioni 4.6 dhe 4.7 thuhet se: shpenzimet mbi asetet ekzistuese duhet të kapitalizohen nëse ato zgjasin dukshëm jetën e asetit; të gjitha shpenzimet për zëvendësimin e linjave ajrore dhe kablove të nëndheshme duhet të kapitalizohen; të gjitha blerjet e mjeteve dhe pajisjeve me vlerë mbi 3.000 € duhet të kapitalizohen; etj.

Trajtimi i kësaj kategorie të mirëmbajtjes nga ana e ZRrE ka ndryshuar me vite.

Në procesin e SHTE 3 për përcaktimin e tarifave të vitit 2009, vlera prej 1,603.4 € e mirëmbajtjes së kapitalizuar nga ana e KOSTT në vitin 2008 është pranuar nga ZRrE dhe është vendosur në RABf. Në shqyrtimin pasues SHTE 4, ZRrE ndërron qasjen ndaj kësaj kategorie dhe vendos që vlerën prej 5,136.6 € të mirëmbajtjes së kapitalizuar gjatë vitit 2009 mos ta pranojë dhe si pasojë kjo vlerë edhe sot e kësaj dite ka mbetur pezull dhe nuk është trajtuar në asnjërën kategori të shpenzimeve. Tani jemi në mes të procesit të SHTE 5 dhe sipas Raportit Konsultativ të datës 22 shkurt 2011, ZRrE pjesën e mirëmbajtjes që dedikohet për ripërtëritjen e rrjetit të kërkuar nga KOSTT e ka zhvendosur nga Shpenzimet Operative tek Shpenzimet Kapitale dhe kërkon që tash e tutje KOSTT ta përdor këtë mënyrë të mbledhjes së “pagesës për ripërtëritje”.

Në mënyrë që kjo qasje të jetë konsistente me trajtimin e kapitalizimit në çdo vit, KOSTT kërkon që vlera e kapitalizimit të mirëmbajtjes prej 5,136.6 € e realizuar gjatë vitit 2009 e cila është mbetur e patrajtuar, të trajtohet në këtë shqyrtim në mënyrën e propozuar nga ZRrE për trajtimin e kësaj kategorie për vitin 2011. Pra kjo vlerë t'i bashkëngjitet kategorisë së Shpenzimeve Kapitale ashtu siç propozon ZRrE të veprohet me këtë kategori në vitin 2011.

Baza rregullative në Metodologji për këtë kërkesë mund konsiderohet dispozita e mëposhtme:

### ***4.4 Përcaktimi i Shpenzimeve Operative***

*Gjatë periudhës së parë të kontrollit të çmimit, ZRrE-ja pret që sasia dhe cilësia e të dhënave mbi kosto operative të OST-së, do të përmirësohen dukshëm. ZRrE-ja gjithashtu pret që adaptimi i kontrollit të çmimit të bazuar në stimulim, do të inkurajojë OST-në që të zbulojë nivelin e “vërtetë” të shpenzimeve. Në vënien e të ardhurave të lejuara për kontrollin e dytë dhe vijues të çmimit, ZRrE-ja pret t'i shfrytëzojë këto të dhëna më të mira për të bërë krahasime të shpenzimeve të OST-së dhe OST-ve të tjera ndërkombëtare për të ndihmuar në formimin e një gjykimi në nivelin e arsyeshmërisë së tyre.*



	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-CLRR-032</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 8 nga 11</i>

*Gjatë periudhës së kontrollit të parë të çmimit, ZRrE-ja do të zhvillojë qasjen e saj ndaj këtij krahasimi, duke u bazuar në përvojën dhe metodologjinë e zhvilluar nga rregullatorët e tjerë të BE-së.*

### 4.3 Shpenzimet e Personelit

Ne Raportin Konsultativ për SHTE 5 për shpenzimet e personelit ZRrE ka paraqitur qasjen lidhur me trajtimin e këtyre shpenzimeve duke krahasuar kostot mesatare të personelit të KOSTT me kostot mesatare të personelit të të punësuarve të tjerë me profil të krahasueshëm në sektorin e energjisë. Lidhur me këtë, duke u bazuar edhe në përvojat e vendeve tjera të rajonit, KOSTT vlerëson se kriteri për krahasimin e mesatares së pagave i përdorur nga ZRrE në Raportin Konsultativ për caktimin e të hyrave të lejuara për kostot e personelit, s'mund të jetë bazë për KOSTT, për arsyt në vijim:

- Nuk mund të bëhen krahasime për mesatare të pagave në mes të kompanive, struktura kualifikuese e të cilave ndryshon rrënjësisht, faktor ky i cili është faktor kyç i llogaritjes së pagës mesatare. Në rast se do të bëhet krahasimi i niveleve të pagave për kualifikime të njëjta, del se KOSTT qëndron në nivel të njëjtë ose më të ulët se kompanitë tjera në sektorin e energjisë.
- Në strukturën kualifikuese të KOSTT, rreth 50% të stafit (48.6%) është me kualifikim superior, derisa kjo përqindje në sektorin e energjisë në Kosovë, është dukshëm më e ulët (kjo strukturë në KEK është afërsisht 10%). Prandaj konstatimi i lartpërmendur është i qëndrueshëm. Në këtë drejtim, pjesëmarrja e stafit me kualifikim superior në KOSTT është dukshëm më e lartë edhe nga vendet e rajonit. Kjo është si pasojë e strukturës organizative që përcakton departamente dhe sektorë të përgjegjësive të njëjta por me numër më të vogël të ekzekutuesve, që janë në subordinim të këtyre departamenteve, respektivisht sektorëve.
- Buxheti i shpenzimeve të personelit sipas aplikacionit të KOSTT paraqet 16.5% të të hyrave të përgjithshme të KOSTT për vitin 2011. Nëse këto të dhëna krahasohen me KEK, sipas pasqyrave financiare të publikuara në ueb faqe, del se për vitin 2009, pjesëmarrja e shpenzimeve të personelit në të hyrat e rregulluara të KEK-ut është **26.8%**<sup>1</sup>. Nga ana tjetër, kostoja mesatare e personelit në KOSTT gjatë periudhës 2007-2011 sillet prej **13.2%** deri **13.6%**<sup>2</sup>.

Kjo pjesëmarrje në vitin 2011 është më e lartë (16.5% në krahasim me 13.6%) se mesatarja e viteve paraprake si pasojë e eficiencës në zvogëlimin e shpenzimeve për humbjet në transmision si dhe zvogëlimin e kërkesës për buxhetin e mirëmbajtjes. Zvogëlimi i këtyre dy kategorive ka rezultuar me zvogëlimin e kërkesës për Të Hyrat Totale dhe prandaj përqindja e pjesëmarrjes së buxhetit të personelit duket më e madhe se vitet e kaluara.

<sup>1</sup> [http://www.kek-energy.com/doc/publikime/KEK%20-Raporti%20i%20auditorit%20te%20pavarur%20dhe%20PF%20per%20fund%20vitin%2031-Dhjetor%202009%20\(30.09.2010\).pdf](http://www.kek-energy.com/doc/publikime/KEK%20-Raporti%20i%20auditorit%20te%20pavarur%20dhe%20PF%20per%20fund%20vitin%2031-Dhjetor%202009%20(30.09.2010).pdf), fq.4

<sup>2</sup> Shih Aplikacionin final të KOSTT- Plotesime, Tabela 1, faqe 4



	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-CLRR-032</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 9 nga 11</i>

- Në shtetet e rajonit kjo pjesëmarrje është si vijon: Shqipëri (OST Albania) 21.8%<sup>3</sup> Serbi (Elektromreza Srbije) 16.6%<sup>4</sup>; Mali i Zi ( Crnogorski Elektroprenos) 27%<sup>5</sup> si dhe Maqedoni (MEPSO) 12.7%<sup>6</sup>. Nga këto të dhëna del se mesatarja e pjesëmarrjes së shpenzimeve të personelit në të hyrat totale në shtetet e rajonit është 19.5%, pra KOSTT qëndron dukshëm nën këtë mesatare.

Në kohën kur jemi duke u ballafaquar me një rritje të indeksit të çmimeve të konsumit, mosmarrja parasysh e këtij kriteri dhe caktimi i shpenzimeve të personelit nën nivelin e shpenzimeve të lejuara për vitin paraprak, përkundër rritjes së numrit të punëtorëve (nga 214 në 2010 në 245 në vitin 2011) dhe performancës së lartë të treguar në punë, e sjell KOSTT në një situatë të ndjeshme dhe më pak motivuese për ta mbajtur trendin e efikasitetit aktual.

Norma mesatare e rritjes së indeksit të çmimit të konsumit për 2010 në krahasim me 2009 ka qenë rreth 6.6%.<sup>7</sup>

**Bazuar ne këto arsytetime kërkojmë nga ZRrE të bëjë korrigjimin në Raportin Konsultativ dhe koston e personelit ta kthej në vlerën e kërkuar nga KOSTT.**

Në favor të kërkesës për mos ndryshimin e buxhetit të pagave kemi dispozitën e mëposhtme të Metodologjisë në vazhdim:

#### 4.2.2 Rregullimi i bazuar në stimulim

ZRrE-ja nuk propozon që të marrë pjesë në analiza të shpeshta dhe të detajuara "hap-pas hapi" të arsyeshmërisë së niveleve ekzistues të kostove, proces të cilin ZRrE-ja e konsideron si jo efektiv, duke qenë se botëkuptimi i ZRrE-së është shumë më i kufizuar ndaj kostove të OST-së në lidhje me njohurinë e menaxhimit të tij dhe për të përfshirë ZRrE-në në mikro-menaxhimin e OST-së, që nuk bën pjesë në funksionet e rregullatorit. Në fakt, ZRrE-ja do të miratojë një qasje të bazuar në stimulimin për të rregulluar kostot e OST-së.

#### 4.4 Shërbimet ndihmëse

Të hyra nga shpenzimet ndihmëse që ishte dashur të paguajmë EMS-it si furnizues, nuk jemi duke i bërë si reciprocitet ndaj refuzimit të tyre për transferimin e fondeve që arkëtohen në emër të kapaciteteve të alokuara të interkonektorëve të KOSTT. Ashtu si janë paraparë me Rregulloren 1228 këto mjete do të shfrytëzoheshin për ndërtimin e interkonektorëve. Prandaj të hyrat e KOSTT për

<sup>3</sup> <http://www.ost.al/download/Analiza%20ekonomiko-financiare%202009.pdf>

<sup>4</sup> [http://www.ems.rs/stranice/poslojne\\_informacije/re%20izvestaj/2008/Konsolidovani%20finansijski%20izvestaji%20JP%20EMS%20za%202008.%20g%20i%20izvestaj%20nezavisnog%20revizora%20po%20konsolidov%20fin.%20izvestajima%20JP%20EMS%20za%202008.pdf](http://www.ems.rs/stranice/poslojne_informacije/re%20izvestaj/2008/Konsolidovani%20finansijski%20izvestaji%20JP%20EMS%20za%202008.%20g%20i%20izvestaj%20nezavisnog%20revizora%20po%20konsolidov%20fin.%20izvestajima%20JP%20EMS%20za%202008.pdf)

<sup>5</sup> <http://www.scmn.me/fajlovi/PREN200912.pdf>

<sup>6</sup> [http://www.mepso.com.mk/CMS99/Content\\_Data/Dokumenti/Финансиски%20извештаи/2.1%20Биланс%20на%20успех.pdf](http://www.mepso.com.mk/CMS99/Content_Data/Dokumenti/Финансиски%20извештаи/2.1%20Биланс%20на%20успех.pdf)

<sup>7</sup> Enti i Statistikës i Kosovës : Statistikat ekonomike, Seria 3 : Indeksi i Çmimeve të Konsumit, dhjetor 2010, fq.5

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-CLRR-032</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 10 nga 11</i>

Shërbimet Ndihmëse janë baza që ju tregohet sponsorëve për ndërtimin e linjave të interkoneksionit, në rastin specifik projekti i linjës 400 kV Kosovë – Shqipëri, si zëvendësim për të hyrat nga kongestionet të cilat KOSTT nuk është duke i arkëtuar si pasojë e problemeve politike me Serbinë.

Të hyrat e estimuara prej kongestionëve janë kalkuluar dhe vlera e tyre është afërsisht 2.000 k€/vit. Këto të hyra janë të ndara në llogari të veçantë bankare.

Përcaktimet sipas Metodologjisë mund të shihen në vazhdim:

#### **4.9 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e Përjashtuara**

*Ndërlidhësit përfshihen në BAR. Sidoqoftë, të ardhurat nga ankandet e kapacitetit të ndërlidhësve të ndërrmarra në përputhje me mekanizmin për menaxhim të kongestionit janë të lidhura në mënyrë zinxhirore me të ardhurat e tjera të rregulluara. Në vend të kësaj, ato janë të akumuluar në një fond të veçantë. Në përputhje me këto principe të paraqitura në Rregulloren e BE mbi shkëmbimet ndër kufitare (cross-border exchanges<sup>4</sup>), të ardhurat do të lirohen nga ky fond në një bazë vjetore siç është aprovuar nga ZRrE-ja, në mënyrë që të:*

- *Garantojë disponueshmërinë reale të shpërndarjes së kapacitetit të linjës ndërlidhëse; dhe*
- *Garantojë investimet që mirëmbajnë apo ngrenë kapacitetet ndërlidhëse, kostot e të cilave janë subjekt për rishikim dhe aprovim nga ZRrE për investimet e propozuara.*

#### **4.5 Shpenzimet tjera**

Në shpenzimet tjera të përgjithshme, përveç sigurimit të pasurisë prej 450.000 €, që është obligim sipas licencës, hyjnë edhe këto shpenzime:

- Rritja e shpenzimit për Kompensimin e dëmeve personave të tretë (për 184.400), që ka të bëjë me kompensimet e dëmeve materiale dhe kompensimet për shpronësimin e tokave për Paket projektin Ferizaj 2
- Rritja e tatimit në pronë (për 24.000 krahasuar me vitin paraprak) për shkak të objekteve të reja, në radhë të parë Peja 3
- Shpenzimet e rritura të energjisë elektrike në këto objekte të reja (për 17.000 € në krahasim me vitin paraprak)
- Shpenzimet për Modelin Financiar (30.000 €) të KOSTT, i cili do të ndihmojë në parashikimin afatgjatë të pasqyrave financiare dhe analizave të ndryshme që janë të domosdoshme për planifikimin strategjik të KOSTT. Modeli do të jetë i bazuar në Metodologjinë e tarifave të ZRrE.

Bazuar në këto arsye të kërkuara nga ZRrE të bëjë korigjimin në Raportin Konsultativ dhe koston e **shpenzimeve tjera** ta kthejë në vlerën e kërkuar nga KOSTT.

#### **4.6 Problematika e financimit të projekteve kapitale 2011 nga BK**

	<b>APLIKACIONI PËR TARIFA</b>	<b>FO-CLRR-032</b>
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 11</i>

Shfrytëzohet rastin të Ju informojmë me problematikën e financimit të disa projekteve nga Buxheti i Kosovës që në ndërkohë na është komunikuar. Projektet janë në realizim dhe përfundohen gjatë këtij viti. KOSTT duke analizuar situatën e krijuar dhe obligimet kontraktuale që ka, këtë problem mund ta zgjedhë vetëm nga buxhetet e KOSTT, prandaj zvogëlimi i të hyrave për vitin 2011 do ta sjellë KOSTT në vështirësi shumë të mëdha financiare.

Bazuar në shkresën e datës 28.02.2011 të pranuar nga Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, shihet se draft buxheti i lejuar për KOSTT është në vlerë 8,214.776, kurse nevojat për mbulimin e obligimeve nga mjetet e buxhetit të Kosovës është në vlerë 11,341.992. Nga kjo shihet se KOSTT do të ballafaqohet me një deficit vetëm për këto projekte në vlerë prej (3,127.216)

Për mbulimin e këtij deficiti, KOSTT duhet të gjejë alternativa tjera (mundësinë e marrjes së ndonjë kredie komerciale).

Projektet	Buxheti i Kosoves (BK)	Nevojat për vitin 2011	Mungesë në mjete
SCADA/EMS & Telekom	<b>1,524.050</b>	2,370.237	(846.187)
Paket Projekti 400/110 kV - Peja 3 (Linja 110 kV & TS Skenderaj dhe Linja 110 kV Kline)	<b>2,322.283</b>	2,322.283	-
NS 400/110 kV – Ferizaj 2 (LOT1)	<b>4,368.443</b>	6,649.472	(2,281.029)
<b>TOTAL</b>	<b>8,214.776</b>	<b>11,341.992</b>	<b>(3,127.216)</b>

Nëse ZRrE nuk bënë korrigeimet e kërkuara në Raportin Konsultativ, KOSTT do të jetë në një situatë shumë të vështirë financiare, duke rrezikuar edhe implementimin e këtyre projekteve.

Prandaj të hyrat e KOSTT duhet të ndahen në nivelin e aplikacionit që të mbulojnë këtë risk të paparashikuar.

## 5. Kërkesat e KOSTT për t'u marr parasysh në Vendimin Final

KOSTT mendon se Raporti Konsultativ i cili është propozuar nga ZRrE duhet të ndryshojë dhe ulja prej 22% e të hyrave të KOSTT duhet të korrigojë në 9% dhe vlerës prej 14.1 milion t'i shtohen:

1. 313.508 €, në emër të nxitjes së efijencës në vazhdim të uljes së kostos së humbjeve;
2. 405.021 €, në emër të kapitalizimit të mbetur të vitit 2009 të aseteve të blera nga buxheti i ripërtëritjes dhe mirëmbajtjes;
3. 639.000 €, rikthimi i uljes në buxhetin e pagave
4. 257.000 €, rikthimi i shpenzimeve tjera të zbritura

- Fundi i dokumentit -